



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM  
Nr. 17, datë 30.01.2025

PËR

**“CAKTIMIN E PËRKOHSHËM NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË  
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT  
TË PËRGJITHSHËM LEZHË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

<b>1. Znj. Mirela BOGDANI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>2. Z. Erind GERMENJI</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>3. Znj. Ledina RIZA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>4. Znj. Arta MANDRO</b>	<b>Anëtar (në mungesë)</b>
<b>5. Z. Zeqir HODA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>6. Z. Sokol STOJANI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>7. Z. Moisi DUDA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>8. Z. Vatë STAKA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>9. Z. Olger EMINAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>10. Z. Erind MERKURI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>11. Z. Erion FEJZULLA</b>	<b>Anëtar</b>

në mbledhjen e datës 30.01.2025, konform procedurës së përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Caktimin e përkohshëm në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”**

## BAZA LIGJORE:

- i. Neni 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
- ii. Nenet 42, pika 2 dhe 59 të ligjit nr.96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar;
- iii. Nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar;
- iv. Rregullore *“Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”* e ndryshuar.

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë nga:

- i. Relacioni shoqërues nr.83., datë 14.01.2025, i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës;
- ii. Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

## V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me vendimin e KLP-së nr.354, datë 03.11.2021, prokurori Erjon Shehaj është caktuar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Ushtrimi i këtij funksioni për prokurorin Shehaj ka përfunduar në datë 02.11.2024.
3. Prokurori Erjon Shehaj ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kërkesën për rikandidim në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, mbështetur në pikën 2 të nenit 52 të Ligjit për Statusin (shkresë e protokolluar në Zyrën e Protokollit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me nr. 1344 prot., në datën 10.06.2024).
4. Këshilli, në zbatim të pikës 3, të nenit 52 të Ligjit për Statusin, si dhe Rregulloreve *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”* e ndryshuar dhe *“Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”* me Vendimin Nr.145, datë 18.07.2024, ka filluar procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për riemërim në pozicionin e drejtuesit në



Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë z.Erjon Shehaj, si dhe ka caktuar me short relatorin për këtë procedurë.

5. Aktualisht, *procedura e vlerësimit* (Vendimi Nr.406, datë 28.12.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë), sipas Rregullores “Për vlerësimin e drejtuesit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm” për prokurorin Erjon Shehaj, që ka rikandiduar për një mandat të dytë në pozicionin e drejtuesit, është ende në vijim.
6. Duke qenë se, mandati i drejtuesit aktual të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, përfundoi në datë 02.11.2024, dhe për shkak se, procedurat administrative lidhur me verifikimin e pasurisë dhe figurës, si dhe vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale sipas vendimeve të sipërcituara nuk kishin përfunduar, me vendimin nr. 231, datë 29.10.2024, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi caktimin përkohësisht të zotit Erjon Shehaj, në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një periudhë deri në tre muaj. Kjo vendimmarrje e Këshillit është bazuar në:

Nenin 59 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili parashikon se:

*“1.Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet përkohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:*

- a) caktimit në pozicione të tjera,
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.

Në referim të nenit 42/2, të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se:

*“... Pozicioni është përkohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është përkohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”*

Referuar nenit 3 të Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, miratuar me Vendimin Nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, përcaktohet se:

*Neni 3*

*Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve  
Prokurori mund të caktohet përkohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.*

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.

7. Ndërkohë, në datën 02.02.2025, përfundon afati i caktimit të përkohshëm për prokurorin Erjon Shehaj.
8. Në të tilla rrethana, kur procedurat administrative lidhur me verifikimin e pasurisë dhe figurës, si dhe vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale sipas vendimeve të sipërcituara, sikundër na është bërë me dije nga Komisioni i Veprimtarisë Etike dhe Profesionale ende nuk kanë përfunduar, me qëllim për të ruajtur frymën e ligjit dhe në përgjigje të situatës së krijuar, Komisioni vlerëson se, caktimi i përkohshëm i prokurorit Erjon Shehaj, në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë duhet të vijojë.

**Për sa më sipër Këshilli i Lartë i Prokurorisë, konstaton se:**

1. Plotësimi i pozicionit vakant të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë është proces që garanton organizimin e punës, mirëfunksionimin e prokurorisë, përfaqësimin e prokurorisë në marrëdhënie me të tretët etj. Këshilli vlerëson se zoti Erjon Shehaj përmbush kriteret ligjore për të ushtruar këtë funksion si i caktuar përkohësisht.
2. Ky caktim i përkohshëm me afat deri në tre muaj, mund të ndërpritet në çdo moment nëse Këshilli vendos të vijojë me procedurat e emërimit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Zoti Erjon Shehaj, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.
2. Zoti Erjon Shehaj do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për një periudhë deri në tre muaj, duke filluar nga data 03.02.2025.





3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Erjon Shehaj, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 30.01.2025.



**KRYETAR**  
**Mirela Bogdani**

**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Moisi Duda**

**ANËTAR**  
**Erind Merkuri**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Vatë Staka**

**ANËTAR**  
**Erion Fejzulla**

**ZV/KRYETAR**  
**Erind Gërmenji**

**ANËTAR**  
**Ledina Riza**

**ANËTAR**  
**Olger Eminaj**